



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilaj, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit lidhur me ndikimin e jashtëligjshëm të pretenduar të dëshmitarëve, deklaratat përmbyllëse janë caktuar të mbahen më 10, 11 dhe 14 shtator 2026, ku seancat do të fillojnë në orën 9:30 paradite, në të tri ditët.

Më 20 gusht, Gjykatësi i Vetëm për Gjykimin e Çështjes miratoi kërkesat e Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit për të ndjekur deklaratat përmbyllëse përmes videolidhjes.

Gjatë deklaratave përmbyllëse, palët përmbledhin argumentet e tyre si dhe mund t'u referohen provave dhe, mbështetshmërisë në to, si dhe besueshmërisë së dëshmitarëve, dokumentacionit të procesit si dhe kornizës ligjore përkatëse. Sipas Rregullores, Prokurorja e Specializuar fillon e para me deklaratën përmbyllëse dhe më pas vijojnë ekipet e Mbrojtjes. Pas kësaj, palët kanë të drejtë t'i përgjigjen njera-tjetrës dhe të akuzuarit kanë të drejtë të flasin të fundit. Pas deklaratave përmbyllëse, Gjykatësi i Vetëm për Gjykimin e Çështjes mbyll çështjen.

Seancat më 10, 11 dhe 14 shtator do të jenë publike dhe mund të përcillen në shqipe, serbishte dhe anglishte përmes [faqes së internetit të DHSK-së](#), me 45 minuta vonesë, ose nga galeria për publikun në mjediset e gjykatës. Mesazhet elektronik të konfirmimit u janë dërguar të gjithë atyre që janë regjistruar paraprakisht për të qenë të pranishëm në deklaratat përmbyllëse.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, kujtojmë se, shqiptimi i Aktgjykimit është caktuar të mbahet më 16 shtator 2026, duke filluar në orën 10:00.

Dërgimi i mesazheve elektronike personave që kanë bërë kërkesë për të ndjekur seancën personalisht në Dhomat e Specializuara është në proces e sipër. Sikurse është thënë më herët, të gjitha përgjigjet do të dërgohen jo më vonë se dy javë para seancës.

Krahas galerisë për publikun, ku numri i ulëseve është i kufizuar, DHSK-ja do të mundësojë për përfaqësuesit e medias sallën e konferencave të shtypit të Gjykatës dhe qendrën për median. Salla për konferencat e shtypit do të përdoret posaçërisht që gazetarët të mund të përcjellin seancën nga ekranet me 10 minuta vonesë. Në qendrën e medias, e cila shërben si vend për të punuar një hapësirë kushtuar medias, gazetarët mund të incizojnë transmetimin me vonesë të seancës dhe të përgatisin artikujt e tyre.

Kërkojmë mirëkuptimin e personave që nuk mund të jenë të pranishëm atë ditë në ndërtesë, pasi interesi për të përcjellë këtë seancë ka qenë jashtëzakonisht i madh, numri i ulëseve është i kufizuar dhe ishte e





KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**
Nr. 30/2026
Hagë, 27/08/2026

domosdoshme t'u jepej përparësi familjarëve të ngushtë. Seanca do të transmetohet përmes faqes në internet, ku mund të shihet ngado nëpër botë në shqipe, anglishte ose serbishte me një vonesë të shkurtër prej 10 minutash.

